



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 10/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal të Klinës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.10/2026, e datës 12.02.2026, e Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal të Klinës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.10/2026 me datën 12.02.2026 nga Arif Elezaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik AAK, i cili thekson se pas certifikimit të rezultateve të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2025, në Kuvendin Komunal të Klinës janë krijuar fillimisht katër (4) pozita të lira si pasojë e dorëheqjeve të anëtarëve nga radhët e subjektit politik AAK, e më pas dhe një (1) tjetër, duke e quar kështu numrin në pesë (5). Nga katër anëtarët e dorëhequr fillimisht, tre (3) i përkisnin gjinisë mashkullore dhe një (1) gjinisë femërore. KQZ përmes vendimeve të kontestuara, ka bërë zëvendësimin e tyre duke emëruar dy (2) meshkuj dhe dy (2) femra. Ky zëvendësim është bërë duke anashkaluar radhën e votave të kandidatëve të certifikuar në listën e rirenditur. Konkretisht, mandati i liruar nga një anëtar i gjinisë mashkullore i është kaluar një kandidateje të gjinisë femërore, duke anashkaluar të zëvendësuarin e fundit z, Faton Berisha, si kandidatin pasues me numrin më të madh të votave të gjinisë së njëjtë. Më tej në ankesë theksohet se sikur këto zëvendësime të bëheshin sipas ligjit, zëvendësimi i fundit i cili dhe ka krijuar legjitimitet për ankuesin për të parashtruar ankesë, më saktësisht Vendimi 01/227-2026 i datës 06.02.2026, i pranuar nga ankuesi më 11.02.2026, Në momentin e marrjes së këtyre vendimeve, përfaqësimi i gjinisë femërore brenda grupit të anëtarëve të AAK-së në Kuvendin Komunal të Klinës ishte veç se i përmbushur mbi pragun ligjor prej 30%. Rrjedhimisht, nuk ka ekzistuar asnjë detyrim apo

nevojë ligjore për të aplikuar masa të jashtëzakonshme për ruajtjen e kuotës në dëm të radhës së votave.

Neni 10, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale përcakton se anëtari i kuvendit zëvendësohet nga "kandidati i radhës i kualifikuar i të njëjtës gjini, i cili ka fituar numrin më të madh të votave të KQZ ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë duke transferuar mandatin te gjinia tjetër pa u shterur lista e kandidatëve të gjinisë së njëjtë, Neni 3, pilcat 3.7.1 dhe 3.7.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 tutje thekson se këto dispozita e obligojnë KQZ-në që zëvendësimin ta bëjë mbi bazën e gjinisë së njëjtë, vetëm në mungesë të kandidatëve të asaj gjinie mund të kalohet te gjinia tjetër. Në rastin konkret, kandidati Arif Elezaj, i Gjinisë mashkullore ishte i kualifikuar dhe me vota të mjaftueshme për të zënë vendin e liruar. Tutje, Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton qartë se veprimi i KQZ-së përbën shkelje të të drejtës kushtetuese të Ankuesit për t'u zgjedhur, duke aplikuar një interpretim arbitrar, KQZ ka deformuar vullnetin e votuesve dhe ka cenuar parimin e meritokracisë së votës direkte. Në fund, interpretimi i KQZ-së është i kundërligjshëm pasi kuota gjinore prej 30% synohet gjatë certifikimit fillestar, përdorimi i saj gjatë zëvendësimeve, kur kuota është tashmë e përmbushur, përbën tejkalim të autoritetit ligjor dhe interpretim kundër kushtetues të ligjit për zgjedhjet. Prandaj kërkon nga PZAP, që të anulohen vendimet e KQZ, për emërimet në Kuvendin Komunal të Klinës për aq sa ato bien në ndesh me radhën e votave të kandidatëve të gjinisë mashkullore dhe të obligohet KQZ të nxjerrë vendim për emërimin e Ankuesit Arif Elezaj, si anëtar legjitim i Kuvendit Komunal, duke respektuar Nenin 10.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se Subjekti politik AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në Klinë, në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025, ka fituar 13 mandate, tyre 9 burra dhe 4 gra, KQZ, bazuar në kërkesën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Kline, për arsyeje të marrjes së pozitive në ekzekutivin e komunës me datën 14.01.2026 ka bërë zëvendësimin e anëtarëve të kuvendit komunal në përputhje me dispozitat ligjore, përkatësisht nenit 8, paragrafit 4 në ndërlidhje me paragrafin 3, të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidatës më të votuar). Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shurnë subjekte politike të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nënpërfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Po ashtu, legjislacioni zgjedhor në Zgjedhjet Lokale nuk përcakton kuotë për kuvendin komunal si tërësi, por për listat e subjekteve, si vijon: Neni.8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%. Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet rastet KI145/20 dhe KI146/20. Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës si dhe

numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandatë është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jenë një burrë dhe një grua. Gjithashtu, edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2 (dy) pra duhet të jenë dy burra dhe dy gra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30%", i gjinisë së kundërt. Sa i përket procedurës së zëvendësimit të anëtareve të kuvendit komunal, bëhet sipas dispozitave ligjore të nenit 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarëve të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, si dhe Aktgjyqimit në rastet KI145/20 dhe KI146/20, ku është përcaktuar se, pasi të jetë siguruar përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e mëtejme bëhen në bazë të renditjes së kandidatëve, sipas rezultatit zgjedhor. Kuota gjinore, sipas këtij aktgjykimi, zbatohet vetëm deri në arritjen e qëllimit për të cilin është vendosur, përkatësisht për sigurimin e përfaqësimit minimal të detyrueshëm prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar.

PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e pohimeve të palës ankuese, përgjigjes në ankesë dhe vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit gjeti se, ankesa është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo konstatohet se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në dispozitën e nenit 8 par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.

Në Nenin 8 par.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decisive thuhet se :“Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%. Në nenin 10 par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, c) përcakton se nga kandidati i radhës në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik i cili ka pasur koeficientin më të lartë të votave menjëherë pas subjektit paraprak, në pajtim me formulën e përcaktuar në nenin 7.1 të këtij ligji në zgjedhjet e fundit, në rast se nuk mbetet ndonjë kandidat tjetër në listën e rirenditur të kandidatëve të partisë politike paraprake;

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, pasi që kandidatët e zgjedhur nga subjekti politik AAK janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025 në Republikën e Kosovës, dhe njëherit kandidatët nga subjekti në fjalë” janë zgjedhur duke u bazuar në nenin 8 par.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për të arritur përfaqësimin minimum të 30 % të gjinisë së kundërt.

Paneli vlerëson se për situatë të ngjashme si në rastin konkret, ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka vendosur me Aktgjykimet në rastet KI45/20 dhe KI46/20 me të cilin vendim është theksuar se në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron - në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njëjës gjini. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%".

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse".

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.10/2026 më datën 13.02.2026



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.12/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Lumni Sallauka, anëtarë të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "DeJure Laë Firm SHPK", për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal të Klinës, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.10/2026, të datës 13.02.2026, në seancën e mbajtur më datë 19.02.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.10/2026, i datës 13.02.2026, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin A.nr.10/2026, të datës 13.02.2026, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.10/2026, e datës 12.02.2026, e Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë, paraqitur kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal të Klinës.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë ankesën si të bazuar, të anulohet vendimi Anr.10/2026 i datës 13.02.2026 i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për emërimet në Kuvendin Komunal të Klinës dhe të obligohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të nxjerrë vendim për emërimin e Ankuesit Arif Elezaj, si anëtar legjitim i Kuvendit Komunal të Klinës.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatit Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.10/2026, i datës 13.02.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datë 12.02.2026 ka pranuar ankesë nga Arif Elezaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik AAK, i cili thekson se pas certifikimit të rezultateve të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2025, në Kuvendin Komunal të Klinës janë krijuar fillimisht katër (4) pozita të lira si pasojë e dorëheqjeve të anëtarëve nga radhët e subjektit politik AAK, e më pas dhe një (1) tjetër, duke e quar kështu numrin në pesë (5). Nga katër anëtarët e dorëhequr fillimisht, tre (3) i përkisnin gjinisë mashkullore dhe një (1) gjinisë femërore. KQZ përmes vendimeve të kontestuara, ka bërë zëvendësimin e tyre duke emëruar dy (2) meshkuj dhe dy (2) femra. Ky zëvendësim është bërë duke anashkaluar radhën e votave të kandidatëve të certifikuar në listën e rirenditur, duke kërkuar më saktësisht si në ankesë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e kandidatit Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë.

Pas pranimi të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin A.nr.10/2026, të datës 13.02.2026, me të cilën e ka refuzuar ankesën e kandidatit Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit gjeti se, ankesa është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo konstatohet se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në dispozitivin e nenit 8 par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.

Ka shtuar se në Nenin 8 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decitive thuhet se: "Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafi 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%. Në nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit për



Zgjedhjet Lokale, c) përcakton se nga kandidati i radhës në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik i cili ka pasur koeficientin më të lartë të votave menjëherë pas subjektit paraprak, në pajtim me formulën e përcaktuar në nenin 7.1 të këtij ligji në zgjedhjet e fundit, në rast se nuk mbetet ndonjë kandidat tjetër në listën e rirenditur të kandidatëve të partisë politike paraprake;

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara, pasi që kandidatët e zgjedhur nga subjekti politik AAK janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025 në Republikën e Kosovës, dhe njëherit kandidatët nga subjekti në fjalë" janë zgjedhur duke u bazuar në nenin 8 par.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për të arritur përfaqësimin minimum të 30% të gjinisë së kundërt.

Ka shtuar se Paneli vlerëson se për situatë të ngjashme si në rastin konkret, ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka vendosur me aktgjykimet në rastet K145/20 dhe K146/20 me të cilin vendim është theksuar se në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron në çdo rrethanë përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njëjës gjini. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%".

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga kandidati Arif Elezaj kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega Klinë, lidhur me pretendimet për llogaritjen e kuotës gjinore dhe zëvendësimit të tij me kandidaten e gjinisë femërore të të njëjtës parti.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së edhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 8 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: "2 Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e kandidatëve të çdo subjekti politik, numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat. 3. Vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. 4. Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%".

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozita e lartcekur, erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe



i ligjshëm. Në rastin konkret bazuar në dispozitën ligjore nga neni 8 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, rezulton fakti se lista finale e kandidatëve për assemble komunale duhet të përfshijë së paku tridhjetë përqind (30%) të kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar. Në rastet kur numri i përgjithshëm i kandidatëve në listë është i vogël dhe përqindja nuk jep një numër të plotë, kuota gjinore përcaktohet në numrin më të afërt më të madh, në mënyrë që të garantohet përfaqësimi minimal ligjor. Kështu, për një listë me katër (4) kandidatë, 30% përbën 1.2, që rezulton në dy (2) kandidatë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Nëse vlerësojmë si tërësi nga gjithsej katër (4) kandidatë, përfaqësimi me vetëm një kandidate nga radhët e gjinisë femërore, përbën vetëm 25% të përfaqësimit, që nënkupton se është nën minimumin e paraparë prej 30 %, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të lartcekura. Gjykata Supreme e Kosovës, mori parasysh faktin se me përfaqësimin prej dy kandidatëve të gjinisë femërore në rastin konkret, përfaqësimi arrin në 50%, mirëpo kjo nuk bie ndesh me frymën e ligjit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prandaj vendosi që ankesën e kandidatit ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se përfaqësimi gjinor nuk është vetëm një kërkesë formale në përbërjen e listës, por një detyrim që zbatohet edhe gjatë shpërndarjes së mandateve, në mënyrë që të sigurohet përfaqësim efektiv i të dy gjinive në institucionet e zgjedhura. Nëse shpërndarja e mandateve bazuar në votat e arritura do të çonte në përfaqësim nën 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, ulësja i takon kandidatit/kandidates së asaj gjinie, edhe nëse kandidati tjetër ka më shumë vota, për shkak se mbizotëron parimi i përfaqësimit të barabartë gjinor, i paraparë me ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Zëvendësimi i anëtarëve të dorëhequr nuk përcakton kusht që duhet të vie nga gjinia e njëjtë përveq rasteve kur mund të cenohet 30 % i kuotës gjinore, që nënkupton se në rastin konkret zëvendësimi i kandidatit të gjinisë mashkullore me kandidatin e gjinisë femërore që është ndër kandidatët me vota më shumë se sa ankuesi është në frymën e ligjit dhe përfaqësimit dhe asesi nuk përbën bazë të diskriminimit pas zëvendësimit e kandidatëve duhet të bëhen në bazë të rezultatit zgjedhor, pa u kufizuar në aspektin e zëvendësimit në bazë të gjinisë së njëjtë, përderisa nuk rrezikohet minimumi i përfaqësimit të gjinisë së nën përfaqësuar. Kjo është në përputhje të plotë me Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të cilave iu është referuar PZAP-jë në vendim. Tejkalmi i kuotës duke iu referuar rezultatit zgjedhor nuk përbën shkelje ligjore e as diskriminim por drejtësi në ndarje të ulësive sepse kuota është pragu minimal pavarësisht rezultatit ndërsa pas plotësimit të kuotës vjen në shprehje rezultati.

Prandaj, pretendimi i kandidatit në ankesë se ulësja në Kuvendin Komunal i takon atij nuk qëndron ligjërisht, pasi një veprim i tillë do të shkelte dispozitat mbi kuotën gjinore dhe do të cenonte përfaqësimin minimal prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar në Kuvend Komunal.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.12/2026, datë 19.02.2026.



Republika e Kosovës
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Kryetari i kolegjit,
Faton Ademi

Funzioni i autorizuar
Ovlašćeni radnik